



# & KTHIM PENDIM

SFIDAT E RIINTEGRIMIT TË EMIGRANTËVE  
TË KTHYER NË TREGUN E PUNËS



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

## AUTORËT:

*PhD C. Armela Xhaho, Hulumtuese, IDM*

*Prof. Assoc. Dr. Elvira Fetahu, Eksperte Politikash*

## FALËNDERIME

Dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen tonë Dr. Eda Gemi për komentet dhe sugjerimet e saj të dobishme në draftet e mëparshme të këtij artikulli. Falënderime të veçanta shkojnë për Sara Kelmendin dhe Nensi Vuksanlekaj nga IDM për ndihmën logjistike në të dhënat empirike. Së fundi, ne dëshirojmë të falënderojmë të gjithë të intervistuarit që u bënë pjesë e këtij studimi.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.



Ky dokument politikash i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është prodhuar në kuadër të projektit: "Platforma e Politikave: Ecja përpara në axhendën e integritit të Shqipërisë në BE" mbështetur nga Fondacioni Hanns-Seidel.

Faktet dhe opinionet e shprehura në këtë publikim janë të IDM dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e Fondacionit Hanns-Seidel, i cili nuk mban përgjegjësi për to dhe përdorimin e tyre të mëtejshëm. Përgjegjësia e vetme është e autorëve të studimit.

# TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE	5
II. METODOLOGJIA	6
III. MODELET E MIGRACIONIT TË KTHIMIT	9
3.1 KONTEKSTI: KARAKTERISTIKAT E MIGRACIONIT TË KTHIMIT NË SHQIPËRI	9
3.2 MIGRACIONI I KTHIMIT: SA I RËNDËSISHËM MUND TË JETË PËR VENDIN E ORIGJINËS?	9
IV. ANALIZA E KUADRIT INSTITUCIONAL DHE RREGULLATOR MBI MIGRACIONIN E KTHIMIT	13
4.1 KUADRI STRATEGJIK DHE RREGULLATOR	13
4.2 KUADRI INSTITUCIONAL	14
V. GJETJET KRYESORE: PROFILET E MIGRANTËVE TË KTHYER DHE ARSYET E KTHIMIT	18
5.1 ARSYET E KTHIMIT	18
5.2 POTENCIALI PËR INVESTIM PAS KTHIMIT	21
VI. SFIDAT E RIINTEGRIMIT NË TREGUN E PUNËS	23
6.1 MBËSHTETJA DHE NDIHMA PËR RIINTEGRIM NGA SHTETI	23
6.2 SFIDAT NË NGRITJEN DHE MENAXHIMIN E NJË BIZNESI	24
6.3 KLIMA JO E FAVORSHME E BIZNESIT	25
VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	27
REFERENCAT	30
SHTOJCA 1	33



# I. HYRJE

Migracioni i kthimit është një fenomen i shumanshëm, i diktuar nga faktorë të ndryshëm strukturor dhe personal, siç janë faktorët shtytës: faktorë që motivojnë migrantët të largohen nga vendi i huaj; faktorët tërheqës: zakonisht i referohen situatës ekonomike dhe politike të vendlindjes; karakteristikave individuale të migrantëve; përvojës së tyre e migracionit, marrëdhënieve dhe lidhjeve familjare, etj. Të gjithë këta faktorë formësojnë modelet të ndryshme të kthimit vullnetar (Danaj 2006). Gjatë viteve të fundit, kriza ekonomike globale ndikoi në rritjen e papritur të numrit të migrantëve që kthehen në Shqipëri. Sipas Anketës Kombëtare të Migracionit në Familje, për vitet 2011-2019, numri i shtetasve shqiptarë të kthyer në vitin 2019 ishte afërsisht 95,064 qytetarë. Një përqindje e konsiderueshme (85%) e migrantëve jetonin dhe punonin në tre vendet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë, përkatësisht në Greqi, Itali dhe Gjermani (INSTAT et al., 2020). Pavarësisht nxitësve kryesorë që diktojnë migrimin e jashtëm, në rastin e kthimit të detyruar faktorët lidheshin kryesisht me politikat e migracionit të vendeve pritëse, të cilat mund të kenë sjellë depërtimin e detyruar të migrantëve me dokumentacion të parregullt.

Pavarësisht nga tipologjia e të kthyerve, tendenca në rritje e migracionit të kthimit thekson nevojën e masave për të adresuar sfidat e riintegrit pas kthimit në vendin e origjinës. Në praktikë, mbështetja e riintegrit konsiston kryesisht në nisma dhe projekte të ndryshme, të cilat janë të kufizuara dhe jo të qëndrueshme me kalimin e kohës. Në përgjithësi, mungesa e informacionit për shërbimet që u ofrohen të kthyerve dhe kapacitetet njerëzore institucionale të pamjaftueshme dhe joadekuate në nivel lokal janë barrierat kryesore që pengojnë riintegritin e tyre. Pavarësisht masave të qeverisë shqiptare për lehtësimin e riintegritit të migrantëve të kthyer, kryesisht nëpërmjet strategjive sektoriale, masa të tilla duket se janë shumë të fragmentuara, duke i lënë të kthyerit jashtë skemave të programeve kryesore. Deri më tani, këto programe dhe politika kanë rezultuar të paqëndrueshme në terma afatgjatë. Përveç kësaj, studimet gjithëpërfshirëse dhe të dhënat statistikore për migrantët e kthyer dhe kontributin e tyre potencial në nivel kombëtar janë të pakta. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021 (Komisioni Evropian, 2021) vuri në dukje se kuadri institucional për riintegritin e të kthyerve dhe veçanërisht atyre në kategoritë e cënueshme,

duhet të përmirësohet duke përcaktuar qartësisht përgjegjësitë e aktorëve kombëtar dhe lokal.

Nga ana tjetër, pavarësisht sfidave me të cilat përballen migrantët gjatë procesit të tyre të riintegritit, ata mund të luajnë një rol jetik në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Të kthyerit mund të sjellin në Shqipëri kursimet e tyre, kapitalin njerëzor në trajtën e aftësive dhe njohurive, mentalitetin dhe idetë novatore, kulturën e punës dhe kapitalin social. Deri më tani, studimet që analizojnë situatën e migrantëve shqiptarë të kthyer paraqesin vetëm një tablo të pjesshme të situatës, duke lënë mënjanë sfidat dhe mundësitë e tyre për riintegritin në tregun e punës. Për të adresuar këtë boshllëk, ne kemi ndërmarrë një vlerësim cilësor të situatës së të kthyerve në Shqipëri. Studimi u mbështet në të dhënat parësore, të mbledhura nëpërmjet 37 intervistave të thelluara që u zhvilluan ballë për ballë me migrantët shqiptarë të kthyer nga Greqia dhe Italia, si dhe në të dhëna dytësore dhe analizë dokumentacioni. Fokusi kryesor i këtij studimi është realizimi i një analize të plotë dhe të thelluar të dinamikave të riintegritit të të kthyerve në tregun e punës dhe sfidat me të cilat ata përballen pas kthimit. Krahas kësaj, studimi synon të hedhë dritë mbi kapitalin njerëzor që sjellin të kthyerit, duke kontribuar pozitivisht në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes. Studimi ofron rekomandime të bazuara në evidenca për politikbërësit, me qëllim hartimin e programeve dhe politikave të riintegritit për të kthyerit, si dhe promovimin e kapitalit financiar, human dhe social që kanë fituar jashtë vendit.

Ky studim është i strukturuar në shtatë seksione kryesore. Raporti fillon me pjesën hyrëse dhe vijon me metodologjinë e studimit. Seksioni i tretë ofron një përmbledhje të formave të migracionit të kthimit, duke u fokusuar në analizën e kontekstit, sfidat me të cilat përballen migrantët e kthyer, përfitimet për vendin e origjinës dhe në fund parashtron teorinë e riintegritit dhe barrierat strukturore me të cilat përballen migrantët. Seksioni i katërt analizon kuadrin institucional dhe rregullator dhe boshllëqet në migracionin e kthimit. Seksioni i pestë fillon me një përmbledhje të profileve të migrantëve të kthyer dhe arsyet e kthimit, ndjekur nga seksioni tjetër mbi sfidat e integritit në tregun e punës të të kthyerve. Seksioni i fundit paraqet konkluzionet dhe ofron rekomandime se si të rritet efektiviteti i masave të riintegritit.

## II. METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë strategjitë dhe mekanizmat e riintegrit të të kthyerve në tregun shqiptar të punës. Metodologjia e përdorur në këtë studim konsiston në kombinimin e të dhënave parësore dhe dytësore.

Për sa u përket të dhënave parësore, janë realizuar 37 intervista të thelluara me shqiptarë të kthyer nga Greqia dhe Italia, nga të cilët  $\frac{3}{4}$  përfshinin të kthyerit nga Greqia dhe  $\frac{1}{4}$  të kthyerit nga Italia. Intervistat në terren u kryen përgjatë periudhës 2015-2016 dhe 2021 për të kuptuar më mirë dinamikën e kthimit si pasojë e krizës ekonomike dhe efekteve të pandemisë COVID 19 të të kthyerit. Për të siguruar një përfaqësim gjeografik, të anketuarit u përzgjedhën nga tre rajone kryesore të Shqipërisë: Voskopoja (juglindje), Tirana (në qendër) dhe Fieri (jug).

Pyetësi përbëhej nga 14 pyetje të hapura dhe kohëzgjatja e intervistës ishte afërsisht nga 1 orë deri në 90 minuta. Të gjitha intervistat u regjistruan në audio me miratimin paraprak të të anketuarve. Në intervista u përdor gjerësisht qasja e biografisë, me qëllim analizimin e përvojave jetësore në vendet e destinacionit si dhe identifikimin e sfidave të hasura pas kthimit në vendin e origjinës. Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj metode është sepse mundëson një kuptueshmëri më të mirë të çështjeve dhe lehtëson komunikimin me njerëzit. Gjatë kryerjes së këtij studimi kërkimor, ne u mbështetëm në analizën e flukseve hyrëse të kthimit (qytetarë shqiptarë që kthehen vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës ose vendbanimin e përhershëm, zakonisht pasi kanë kaluar të paktën një vit në një vend tjetër). Identifikimi i pjesëmarrësve në këtë studim u realizua përmes metodës së kampionimit të ortekut të borës- snowballing përmes rrjetëzimeve informale dhe referimeve nga OSHC-të lokale në zonat e synuara.

Nga 37 të intervistuar në total, 19 ishin gra dhe 18 burra, të moshës 18 vjeç e lart, të cilët kishin qëndruar më shumë se një vit jashtë vendit dhe kishin të paktën një përvojë pune në vendin pritës. Sa i përket nivelit arsimor të të kthyerve, shumica e të anketuarve kishin mbaruar shkollën e mesme, afërsisht 67.5%. Ndërkohë, 19% e tyre kishin diplomë universitare. Nga këto përqindje, 38%

kishin emigruar në vitet 1991-1995, 49% midis viteve 1996-2000 dhe pjesa tjetër pas vitit 2000. Për sa i përket statusit profesional para kthimit, gratë ishin kryesisht të punësuar në sektorin e shërbimeve dhe atë të kujdesit shtëpiak, ndërsa burrat në atë të ndërtimit. Pjesa dërrmuese e të kthyerve të anketuar rendisnin kryesisht krizën ekonomike si shkakun kryesor të kthimit. Rreth 81% e të kthyerve i kishin investuar të ardhurat e tyre në një biznes privat pas kthimit. Kjo tregon për një preferencë të lartë të të kthyerve për t'u vetëpunësuar, kryesisht në sektorët e industrisë ku kanë akumuluar mjaftueshëm njohuri teknike "know-how" dhe përvojë.

Siç u përmend më sipër, të dhënat e mbledhura nga kërkimi u analizuan duke përdorur programin kompjuterik Maxqda për të gjeneruar dhe analizuar të dhëna cilësore. Informacioni i pjesëmarrësve u kodua për të respektuar konfidencialitetin e informacionit të tyre personal dhe në përputhje me etikën e kryerjes së studimit. Gjetjet empirike nga analiza e intervistave u plotësuan me të dhëna dytësore të mbledhura nga statistikat zyrtare, shqyrtimi i raporteve, sondazheve dhe dokumente të tjera zyrtare. Kërkesat për informacion zyrtar iu dërguan institucioneve përkatëse që merren me çështjet e migracionit, tregut të punës dhe investimeve të biznesit. Analiza e dokumentacionit konsistoi në shqyrtimin e një game të gjerë literature bashkëkohore me raporte të realizuara nga organizata ndërkombëtare dhe kombëtare, botime qeveritare dhe artikuj akademikë, që trajtonin gjendjen aktuale dhe politikat për migracionin e kthimit. Përveç kësaj, studimi konsistoi edhe në një shqyrtim të kuadrit rregullator dhe institucional ekzistues në Shqipëri. Ky rishikim u përdor gjithashtu si një mjet parësor për të identifikuar mangësitë dhe për të dhënë një pamje të situatës aktuale. Në përfundim, gjetjet dhe rekomandimet paraprake u konsultuan dhe diskutuan në një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të lartë nga institucionet përgjegjëse qeveritare, që punojnë për çështjet e migracionit dhe integrit në tregun e punës, OSHC-të, akademikë dhe përfaqësues nga diaspora.







# III. MODELET E MIGRACIONIT TË KTHIMIT

## 3.1 KONTEKSTI: KARAKTERISTIKAT E MIGRACIONIT TË KTHIMIT NË SHQIPËRI

Referuar literaturës për migracionin ndërkombëtar, vendimi për t'u rikthyer i përket një historie më komplekse migrimi (Garcia-Pereiro, 2019). Në këndvështrimin e Danaj (2006), faktorët që i shtojnë migrantët për t'u kthyer në vendlindjen e tyre ndahen në dy grupe: faktorët shtytës, të cilët konsistojnë në arsyet të cilat motivojnë largimin nga vendi i huaj dhe faktorët tërheqës, të cilët konsistojnë në rrethanat politike dhe ekonomike të vendlindjes së tyre. Në vitet e fundit, vala e kthimit të migrantëve shqiptarë nga Greqia dhe Italia erdhi kryesisht si pasojë e masave shtrënguese pas krizës ekonomike (Gedeshi dhe King, 2008). Të dhënat e fundit nga INSTAT&IOM (2014), ofrojnë një tablo më të qartë për sa u përket profileve dhe karakteristikave të migrantëve të kthyer në vendlindje gjatë viteve të fundit. Të kthyerit preferojnë të jetojnë në Tiranë dhe pjesa më e madhe e tyre janë djem të rinj, që i përkasin popullsisë në moshë pune. Të dhënat nga Anketa Kombëtare e Migracionit të Familjeve Shqiptare për 2011-2019 tregojnë se numri i përgjithshëm i shtetasve shqiptar të kthyer deri në vitin 2019 vlerësohej në rreth 95064 qytetarë. Një përqindje e konsiderueshme (85%) e migrantëve jetonin dhe punonin në tre destinacionet kryesore të migrantëve shqiptarë, përkatësisht në Greqi, Itali dhe Gjermani (IOM, 2020). Studimet kanë treguar se mbështetja dhe riintegrimi i migrantëve të kthyer mbetet ende një sfidë shumë e madhe (Garcia-Pereiro, 2019).

Sipas IOM-it "Riintegrimi mund të përkufizohet si ripërfshirja e një individi në një grup ose proces që iu jep mundësinë migrantëve për t'u integruar sërish në shoqërinë e vendit të tyre të origjinës". Riintegrimi krijon mundësinë e përfshirjes në jetën politike dhe ekonomike të vendit, si edhe në aktivitete sociale e kulturore. Disa nga vështirësitë që hasin të kthyerit për t'u riintegruar renditen si më poshtë:

- » riintegrimi në jetën sociale dhe ekonomike, për shkak të mungesës së informimit mbi shërbimet e disponueshme. Procedurat burokratike mund të pengojnë riintegrimin e efektshëm të migrantëve;
- » migrantët e kthyer zakonisht kanë probleme

në sigurimin e dokumenteve të identifikimit, duke e bërë më të vështirë për ta përfshirjen si grup përfitues në programet aktive të tregut të punës. Për më tepër, mungesa e mundësive dhe niveli i ulët i besimit në institucione, i dekurajon më tej të kthyerit për t'u regjistruar dhe për të kërkuar ndihmë nga institucionet vendore;

- » një pjesë e madhe e migrantëve të kthyer përballen po ashtu me sfida për sa i takon njohjes së kualifikimit dhe aftësive. Duket se në shumicën e rasteve, aftësitë vetjake të të kthyerve nuk përkojnë gjithmonë me nevojat e tregut të punës;
- » ripërfshirja në sistemin arsimor është një tjetër pengesë për riintegrimin e tyre, duke qenë se ata duhet të përballen jo vetëm me pengesat në nivelin administrativ për t'u regjistruar në shkollë, por edhe me paragjykimet dhe qëndrimet jo mikpritëse të bashkëmoshatarëve të tyre (UNDP, 2020; IOM, 2008 2015).

## 3.2 MIGRACIONI I KTHIMIT: SA I RËNDËSISHËM MUND TË JETË PËR VENDIN E ORIGJINËS?


Shqipëria mund të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme nga aftësitë, njohuritë teknike, mendësitë e reja, idetë, dhe kultura e punës etj., që të kthyerit sjellin në vend. Migrantët e kthyer kanë një potencial të madh për kapitalin njerëzor dhe atë social. Kapitali financiar (remitancat dhe kursimet) që migrantët e kthyer sjellin në vendin e tyre, mund të përmirësojnë mungesat e likuiditetit. Migrantët e kthyer konsiderohen si aset dhe në skenarin më optimist kanë potencialin për të stimuluar zhvillimin e vendit. Për më tepër, Labrianidis dhe Lyberaki (2001) dhe Baldwin-Edwards (2004) argumentojnë se migrantët e kthyer kanë tendencën të investojnë në ndërmarrje të vogla, gjë e cila iu jep atyre mundësi për të punësuar edhe familjarët e tyre dhe të investojnë të gjithë kapitalin e përfituar jashtë. Për më tepër, Dustmann dhe Kirchkamp 2002; Ilahi 1999; McCormick dhe Wahba 2001; Mesnard 2004, argumentojnë se nuk ka rëndësi nëse migrantët e kthyer regjistrohen si punëkërkues apo sipërmarrës,

vetë vendi do të përfitonte nga të gjitha llojet e kapitalit që ata do sillnin. Studimet tregojnë për një rritje në kurbën e investimeve të start-up-eve dhe të vetëpunësimit pas kthimit. Pavarësisht nga sa më sipër, kushtet paraprake dhe politikat vendore diktojnë nëse kapitali njerëzor, financiar dhe social i të kthyerve mund të përdoret efektivisht.

Gjasat që migracioni i kthimit të bëhet ose jo një histori motivuese për ata që kthehen sërish, varet më së shumti nga politikat që hartohen nga politikëbërësit. Këto politika duhet të adresojnë në mënyrë koherente nevojat e të kthyerve përmes një qasjeje të koordinuar, shumëdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse.



Figura 1: Tendencat e migrimit të kthimit ndër vite<sup>1</sup>



Burimi: Kërkesë për informacion, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, PSH, 28 tetor 2021

Figura 2. Karakteristikat e të kthyerve, të regjistruar në Sportelet e Migracionit

KARAKTERISTIKAT E TË KTHYERVE	VITE				
	2018	2019	2020	2021	
Fasha e moshës	15-30	125	163	74	93
	30-44	137	225	111	62
	Mbi 45	62	167	52	45

....


1 Ky numër përfshin si të papranueshmit (INAD) ashtu edhe të dëbuarit. INAD është një pasagjer të cilit i refuzohet pranimi në një vend nga autoritetet e atij vendi (p.sh., për shkak të mungesës së vizës, pasaportës së skaduar, mungesës së mjeteve të jetesës, etj.). I dëbuar (DEPA) kur udhëton me një shoqërues ose DEPU kur udhëton pa shoqërues), është një pasagjer që ishte pranuar ligjërisht në një vend nga autoritetet e atij vendi ose që kishte hyrë ilegalisht në një vend dhe që në një kohë të mëvonshme është urdhëruar zyrtarisht nga autoritetet të largohet nga vendi.

KARAKTERISTIKAT E TË KTHYERVE		VITE			
		2018	2019	2020	2021
Arsimi	Arsimi bazë	143	246	119	103
	Arsimi i mesëm	152	251	84	65
	(Pas)universitar	29	58	34	32
Shteti	Greqi	62	179	49	39
	Gjermani		122	100	103
	Itali	55	122	41	103
	BE & Jashtë BE-së	207	132	47	55
Arsyet e kthimit	Papunësia	128	222	56	54
	Dokumentacioni	128	234	137	115
	Arsyet e tjera	68	99	44	31
Tipologjia e kthimit	Kthimi familjar	172	310	66	53
	Kthimi Individual	152	245	171	147
	Afatgjatë	250	456	167	147
	E përkohshme	74	99	70	53
<b>Numri total</b>		<b>324</b>	<b>555</b>	<b>237</b>	<b>200</b>

Burimi: Kërkesë për Informacion, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, 28 tetor 2021

.....

Figura 3. Shërbimet e riintegritimit për të kthyerit që janë paraqitur pranë sporteleve të migracionit



Burimi: Kërkesë për Informacion, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, 28 tetor 2021



# IV. ANALIZA E KUADRIT INSTITUCIONAL DHE RREGULLATOR MBI MIGRACIONIN E KTHIMIT

Kjo pjesë e studimit ofron një vlerësim të kornizës aktuale ligjore, institucionale dhe të politikave në lidhje me kthimin e migrantëve dhe riintegrimin.

## 4.1 KUADRI STRATEGJIK DHE RREGULLATOR

Aktualisht, qeveria shqiptare nuk ka një strategji kombëtare për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer. Strategjia e mëparshme për Kthimin dhe Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë (2010-2015) ka përfunduar në vitin 2015 dhe deri më tani nuk ka ndonjë dokument strategjik që targeton drejtpërsëdrejti riintegrimin. Aspekte të ndryshme të riintegrimin të të kthyerve janë trajtuar pjesërisht përmes strategjive ndërsektoriale, të cilat kanë konsideruar riintegrimin e të kthyerve në fusha të ndryshme si arsim, punësim dhe siguri sociale, duke i kategorizuar ata si një grup potencial vulnerabël. Megjithatë, këto dokumente politikash nuk ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe holistike drejt një procesi të qëndrueshëm riintegrimi të të kthyerve.

Dy dokumentet më të rëndësishme të politikave për migracionin janë **Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit 2019-2022**. Zhvillimi i politikës së qeverisjes të migracionit dhe plani i saj i veprimit përfaqëson një moment historik në arritjen e objektivit 10.7 të SDG-së për të lehtësuar migrimin e rregullt, të sigurt, të përgjegjshëm dhe lëvizshmërinë e njerëzve, duke përfshirë zbatimin e politikave të mirëplanifikuara dhe të mirëmenaxhuara të migracionit. Strategjia dhe Plani i Veprimit ofrojnë një gamë të gjerë veprimesh në katër fusha kryesore, duke përfshirë lehtësimin e kthimit të migrantëve dhe riintegrimin socio-ekonomik të tyre në atdhe. Edhe pse strategjia trajton çështjen e riintegrimin, arritjet nuk janë të qenësishme (UNDP, 2020). Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Brendshme janë institucionet kryesore qeveritare përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (2019-2022). Komiteti Teknik për Migracionin

i drejtuar nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe i përbërë nga drejtues departamentesh të çdo ministrie/institucioni, janë përgjegjës për monitorimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Migracionin. Grupi Drejtues për Migracionin do të krijohet si një organ konsultativ për të mbikëqyrur progresin e përgjithshëm, për të analizuar arritjen e objektivave strategjike të politikës së migracionit dhe për përmirësimin e mekanizmave koordinues.

Për sa i përket riintegrimin në tregun e punës, **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim**, si dhe Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Zhvillimin e Aftësive dhe Plani i Veprimit të saj, parashikojnë disa masa për adresimin e sfidave të të kthyerve si edhe qasjen optimale në punë të denja të ofruara nga tregu formal i punës.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)** përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon axhendën e integritimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Një nga objektivat kryesore të kësaj strategjie është rritja e qëndrueshmërisë së migrimit të kthimit, nëpërmjet mbështetjes dhe riintegrimin. Plani përcakton masat për rritjen e kapaciteteve të sporteleve të migracionit, të cilat ofrojnë: informacion dhe mbështetje për kategori të ndryshme migrantësh; ndërgjegjësim për njohjen e aftësive dhe kualifikimeve (formale dhe joformale) të fituara jashtë vendit nga shtetasit shqiptar dhe integrimin e tyre në tregun e huaj të punës; hartimin e politikave të duhura nxitëse të punësimin, duke përfshirë arsimin dhe formimin profesional, për migrantët e kthyer; promovimin e vetëpunësimin dhe sipërmarrjes së migrantëve të kthyer në zonat rurale.

**Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2019-2022** parashikon në mënyrë indirekte disa masa për riintegrimin e migrantëve të kthyer në tregun e punës. Disa nga këto masa janë: krijimi i një mekanizmi monitorues, që do të monitorojë situatën, veçanërisht atë të personave të prekur nga migrimi; diversifikimi i ofertave të AFP-së sipas tendencave të migracionit; përmirësimi i kapaciteteve të administratës, e cila është përgjegjëse për politikën shtetërore të punësimit dhe migracionit.

**Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar** trajton në mënyrë indirekte çështjen e riintegrimin të të kthyerve, duke ofruar libra shkollor dhe asistencë psiko-sociale falas për nxënësit e kthyer. Në disa raste, drejtoritë arsimore rajonale ngarkohen me përgjegjësi dhe detyra specifike për të ndihmuar riintegrimin e fëmijëve të kthyer.<sup>2</sup>

**Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020** parashikon njohjen e certifikatave të formimit profesional, duke përfshirë edhe përvojën e punës, të fituar jashtë vendit. Plani i veprimit synon të mbështesë të rinjtë e kthyer duke krijuar mekanizma për mbështetjen financiare (siç është skema e fondit të mbështetjes për të rinjtë), duke krijuar lehtësira për shkëmbimin e informacionit dhe duke diversifikuar burimet e komunikimit.

**Ligji “Për emigrimin e shtetasve shqiptar për motive punësimi”** nr. 9668, 18 dhjetor 2006, parashikon disa masa për riintegrimin e të kthyerve dhe mbron të drejtat ekonomike, politike dhe sociale të migrantëve. Sipas nenit 22 të ligjit, “Autoritetet shtetërore përgjegjëse nxisin dhe mbështesin riintegrimin e emigrantëve në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale dhe zbatimit të programeve të zhvillimit të biznesit, të punësimit dhe të formimit profesional nëpërmjet punës”.

**Strategjia Kombëtare e Diasporës (2018–2024)** përcakton disa masa për të nxitur kthimin e migrantëve të kualifikuar dhe fuqizimin e bizneseve të qëndrueshme për ata që kthehen.

## **Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”**

Ky ligj synon të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël nëpërmjet ofrimit të mundësive për punësim. Ato kontribuojnë në mbrojtjen sociale dhe mbështetjen e grupeve të pafavorizuara, duke përfshirë punëtorët migrantë që zhvendosen ose janë të zhvendosur brenda vendit.<sup>3</sup>

## **4.2 KUADRI INSTITUCIONAL**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** është institucioni kryesor shtetëror përgjegjës për ofrimin e mbrojtjes sociale dhe aksesin në shërbimet shëndetësore për të kthyerit. Ministria mbikëqyr veprimtarinë e Shërbimit Social Shtetëror, i cili ofron shërbime për kategoritë vulnerabël, duke përfshirë edhe të kthyerit.

**Ministria e Brendshme**, nëpërmjet Departamentit të Antitrafikimit dhe Migracionit, është institucioni qendror qeveritar përgjegjës për politikën e migracionit. Sektori i Migracionit i departamentit është përgjegjës për hartimin e strategjive dhe procedurave në lidhje me migracionin, shkëmbimin e informacionit dhe ofrimin e asistencës teknike për strukturat rajonale dhe vendore.<sup>4</sup>

Raportet e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit, 2019-2022 dhe Planit të Veprimit përgatiten nga Komiteti Teknik i Migracionit, i krijuar në korrik 2020 pranë Seksionit të Emigracionit në Ministrinë e Brendshme.<sup>5</sup>

**Departamenti i Kufirit dhe Emigracionit, Policia e Shtetit Shqiptar** është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave të disagreguara për migrantët e kthyer (të detyruar ose vullnetar). Megjithatë, institucioni has vështirësi logjistike në regjistrimin e saktë të informacionit mbi vendbanimin e të kthyerve. Qasja e të kthyerve me informacionin në lidhje me mbështetjen institucionale të disponueshme për këtë kategori njerëzish është një tjetër problematikë e evidentuar (UNDP, 2020).

....

2 Shih [https://migrationnetwork.un.org/sites/default/files/docs/1\\_final\\_-\\_consolidatedreport\\_gcm\\_vr\\_albania\\_27\\_tetor\\_2020.pdf](https://migrationnetwork.un.org/sites/default/files/docs/1_final_-_consolidatedreport_gcm_vr_albania_27_tetor_2020.pdf)

3 VKM nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”.

4 Rregullorja e Brendshme, Ministria e Brendshme. [https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Rregullore\\_Ministria-e-Brendshme.pdf](https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Rregullore_Ministria-e-Brendshme.pdf)

5 Dekreti i KM nr.99/2020.

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë** është përgjegjëse për migracionin për motive punësimi në vend në bashkëpunim me ministritë e tjera. Institucioni zhvillon politika për punësimin dhe formimin profesional, të cilat lehtësojnë riintegrimin e qytetarëve shqiptar të kthyer në tregun e punës. Institucioni është përgjegjës për monitorimin e punës, tregun e punës, arsimin, formimin profesional, emigracionin dhe migracionin për motive punësimi, shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe pensionet. Nëpërmjet Departamentit të Politikës së Punësimit dhe Trajnimit Profesional, Sektorit të Politikave të Punësimit dhe Migracionit, kjo Ministri është përgjegjëse për maksimizimin e ndikimit të politikave në punësim për të gjithë qytetarët, përfshirë migrantët.

**Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Zhvillimit të Aftësive** është përgjegjëse për shërbimet e punësimit dhe migrimit përmes sporteleve të migracionit për të lehtësuar riintegrimin e migrantëve në tregun e punës. Migrantët e kthyer mund të marrin informacion mbi mundësitë e punësimit dhe shërbimet e punësimit nga zyrat rajonale dhe lokale të punësimit.

Strategjia e mëparshme për Kthimin dhe Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë (2010-2015) parashikonte ngritjen e **36 sporteleve të migracionit (zyrat e informacionit)** të vendosura në zyrat rajonale të punësimit në të gjithë vendin. Ata duhet të shërbenin si qendrat e qasjes në informacion për imigrantët, migrantët dhe grupet e potenciale të emigrantëve, duke u ofruar atyre udhëzime, konsultime dhe informacione pas kthimit. Për më tepër, ato do të shërbenin si mekanizma për regjistrimin e migrantëve të kthyer. Megjithatë, krijimi i këtyre sporteleve nuk rezultoi i suksesshëm, sepse ato ofronin një numër të kufizuar shërbimesh dhe vetëm disa migrantë u regjistruan vullnetarisht. Këto sportele nuk funksionojnë në të gjitha bashkitë e vendit. Migrantët e kthyer u përballën me sfida të qasjes në kartat e identifikimit personal, certifikimin e diplomave të shkollës dhe marrjen e ndihmës ligjore (UNDP, 2020). Vetëm një numër i kufizuar i migrantëve të kthyer janë në dijeni të informacionit të ofruar nga programet qeveritare për riintegrimin

e migrantëve (Kerpaci dhe Kuka, 2019). Për më tepër, krijimi i bazës së të dhënave të të kthyerve dhe forcimi i kapaciteteve të sporteleve të migracionit vazhdojnë të jenë procese sfiduese (Observatori, 2016).

Qeveria propozoi **Ministrinë e Shtetit për Diasporën**, e cila ishte përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të diasporës në koordinim me ministritë e tjera. Ministria u shpërbë në vitin 2021 pas shpalljes së strukturës së re qeveritare të përbërë nga vetëm 11 ministra. Gjithashtu, në vijim u krijuan disa agjenci përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të diasporës, si Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi për Zhvillimin e Diasporës, Dhoma e Tregtisë së Diasporës, Qendra e Kërkimeve dhe Publikimeve të Arbëreshëve dhe Qendra Botuese e Diasporës. Gjatë viteve të fundit janë krijuar edhe Nënkomisioni Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin, Komiteti Shtetëror i Diasporës, Këshilli Koordinativ i Diasporës dhe Rrjeti i Ambasadorëve të Kombit.

**Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)** është një institucion që është nën varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Fokusi i Agjencisë është rritja e konkurrencës së sektorit privat, forcimi i potencialit eksportues të vendit, nxitja/mbështetja e investimeve të huaja direkte në Shqipëri dhe promovimi i potencialit turistik të vendit. AIDA ofron akses në informacione të përditësuara, ofron një mënyrë efikase komunikimi me organet qeveritare dhe shërben si "One-Stop-Shop", duke mbështetur investitorët gjatë gjithë procesit të investimit. Edhe pse Agjencia ndërmerr të gjitha iniciativat e nevojshme për zhvillimin e sektorit privat dhe përmirësimin e klimës së biznesit, ajo nuk bën dallime ndërmjet investimeve nga migrantët e kthyer, diaspora apo investimet e huaja (Kërkesë për informacion, tetor 2021). Edhe pse AIDA ka asistuar në përgatitjen e një plani, i cili ka për qëllim identifikimin e migrantëve të suksesshëm të kthyer në Shqipëri dhe analizimin e potencialeve të tyre për hapjen e biznesit në vend, ngelet ende shumë punë për zbatimin e kësaj nisme (Rrjeti i Migrimit, 2020).

Aktualisht ka pak iniciativa/programme të drejtuara nga institucione ndërkombëtare si: DIMAK-GIZ<sup>6</sup> IOM<sup>7</sup>

....

6 Shiko programin: <https://www.startfinder.de/en/advisory-centre/german-information-centre-migration-vocational-training-and-career-dimak-tirana>

7 Shiko programin: <https://albania.iom.int/diaspora>

dhe ADF<sup>8</sup> për të kthyerit dhe diasporën shqiptare. Në shumicën e rasteve, programet e asistencës pas kthimit ofrohen për migrantët e kthyer në mënyrë të pavullnetshme. Kësisoj, është e vështirë të sigurohet një ndikim i qëndrueshëm afatgjatë i programeve. Megjithatë IOM-i i ka dhënë mbështetje të vazhdueshme Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me kthimin dhe riintegrimin vullnetar të asistuar të migrantëve shqiptar (Rrjeti i Kombeve të Bashkuara për Migracionin, 2020), nevojiten më shumë përpjekje për t'i bërë nisma të tilla të qëndrueshme në vazhdimësi.

....

8 Shiko programin: <https://aadf.org/project/general-news/#launching-event-of-read-program-research-expertise-from-the-academic-diaspora>





# GJETJET **KRYESORE**



# V. GJETJET KRYESORE: PROFILET E MIGRANTËVE TË KTHYER DHE ARSYET E KTHIMIT

Gjetjet nga intervistat nxorën në pah tre arsye kryesore që nxitën kthimin e migrantëve në vendin e tyre, Shqipëri. Është interesante të theksohet se kthimi në Shqipëri është diktuar kryesisht nga faktorët “shtytës” të lartpërmendur në vendet pritëse dhe më pak nga faktorët “tërheqës” në vendin e origjinës.

## FAKTORËT SHTYTËS

faktorët që motivojnë migrantët të largohen nga vendi i huaj;

Mungesa e mundësive në vendet pritëse;  
Kriza ekonomike;  
Papunësia;  
nëpunësimi;  
Mungesa e dokumentacionit.

## FAKTORËT TËRHEQËS

i referohen situatës ekonomike dhe politike të vendlindjes; karakteristikave individuale të migrantëve; përvojës së tyre e migracionit, marrëdhënieve dhe lidhjeve familjare:

Nostalgjia dhe malli për vendin;  
Arsyet personale familjare, si ribashkimi familjar, dëshira për t'u kujdesur për prindërit dhe fëmijët;  
Interes për të investuar kapitalin financiar dhe human në vendlindje.

## 5.1 ARSYET E KTHIMIT

### 5.1.1 KRIZA EKONOMIKE

Përvojat e migrantëve të kthyer tregojnë se vendimi për t'u kthyer ishte disi i kushtëzuar nga kriza ekonomike që përfshiu Greqinë dhe Italinë. Për shkak të krizës së thellë ekonomike, shumë punëtorë migrantë humbën punën e tyre dhe nuk mund të mbijetonin financiarisht në vendet e destinacionit. Burrat ishin të parët që u goditën nga

masat shtrënguese për shkak të krizës, duke qenë se ata ishin të punësuar kryesisht në sektorin e ndërtimit, i cili u prek negativisht nga kriza. Krahas shqetësimeve dhe ankthit lidhur me punësimin, taksave jashtëzakonisht të larta dhe uljen e kërkesës për punë, të ardhurat e familjeve të tyre u përkeqësuan. Nga ana tjetër, migrantët filluan të punësoheshin në punë që nuk ofronin aspak siguri dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre ngelën pa punë për shkak të shkurtimit të vendeve të punës. Pra, sikurse evidentohet nga pjesa dërrmuese e të kthyerve, kriza rriti predizpozitat për kthim në vendin e origjinës.

Meri, 41 vjeç, tregon:

Pas krizës ekonomike të vitit 2008, fillova të mendoj për mundësi të reja jashtë Greqisë. Mendova të kthehesha në Shqipëri, ndër vende të tjera, sepse mendova se do të kisha mbështetjen që më duhej. Përfundova duke u kthyer në vitin 2012 për arsye ekonomike dhe personale. Edhe pse prindërit e mi jetojnë dhe vazhdojnë të punojnë ende në Greqi, unë isha e vetmja që u ktheva në Shqipëri. Prindërit e mi nuk më penguan ta bëja këtë (Meri, 41).

Ndërkohë, një pjesë e të intervistuarve dëshmuar se Shqipëria kishte ndryshuar shumë që nga koha kur ata ishin larguar. Megjithatë, ndonëse pjesa më e madhe pohuan se në Shqipëri kishin ndodhur shumë ndryshime, këto zhvillime perceptoheshin si tepër minimale. Në realitet, ata u përballën me një lloj tjetër depresioni në vendin e tyre, të shoqëruar edhe me një ndjenjë tjetërsimi.

Nga viti 1998 deri në 2004, Greqia përjetoj një zhvillim të madh. Të gjithë, përfshirë migrantët, po përparonin. Më pas, vura re se si gjërat po përkeqësoheshin; më pak klientë dhe taksa të larta e vështirësuan shlyerjen e detyrimeve për këdo. Ndërkohë, kisha dy fëmijë dhe ishte e pamundur të mbijetoja. Vendosëm të ktheheshim në vitin 2011, pasi kishim dëgjuar shpesh sesi Shqipëria kishte ndryshuar në TV. Për fat të keq, ndryshimet që pamë ishin vetëm për qëllime reklamimi. [...] Unë isha ai që vendosa që të ktheheshim. Familja ime e mbështeti vendimin, por pasi u kthyem, u përballëm me një depresion tjetër social. Ndihesha sikur të isha i huaj në atdheun tim. Gjithçka dukej se kishte ndryshuar nga jashtë, por kjo ishte vetëm për shkak të zhvillimeve ekonomike. Sigurisht, në krahasim me mënyrën se si u largova nga Shqipëria, pa energji elektrike, ujë të pijshëm dhe kasolle, pati disa përmirësime dhe pse minimale (Sandri, 53).

Migrantët që u detyruar të kthehen për shkak të krizës, papunësisë ose mungesës së mundësive në vendet pritëse duket se kanë më pak gjasa të investojnë ose janë më të papërgatitur për mënyrat se si mund të investojnë në Shqipëri. Edhe pse ky grup i të kthyerve nuk përjashton personat që në njëfarë mënyre u detyruan të kthehen për shkak të autoriteteve të vendeve pritëse dhe statusit të tyre të parregullt, ata duket se janë larg arritjes së qëllimeve

të tyre të migracionit dhe mbylljes së suksesshme të ciklit të tyre migrator. Për shkak të kapitalit të pamjaftueshëm financiar, ky grup kishte gjithashtu një predispozitë më të lartë për migrim potencial në një nga vendet e tjera të zhvilluara të BE-së.

### 5.1.2 NOSTALGJIA

Një arsye tjetër e rëndësishme për kthimin ishte malli që kishte kapluar disa prej këtyre migrantëve. Dëshira për tu kthyer në atdhe ishte e kombinuar me nostalgjinë, kujtimet e fëmijërisë së tyre dhe ndjenjat e përkatësisë. Ledi, 51 vjeç tregon se:

Kur arrin një moshë të caktuar, priresh të kesh më shumë mall për atdheun tënd. Isha 22 vjeç kur u largova dhe u ktheva kur mbusha 51 vjeç. Shtëpia e familjes sime është këtu. Nëna ime ndërroi jetë kur ishte 44 vjeçe dhe unë nuk mund ta lija më babin vetëm. Po të mos kisha pasur këtë shtëpi dhe të mos kisha këtë nostalgji të paepur për atdheun tim, nuk do të isha kthyer. Kam bërë gjithë qejfin e mundshëm kur isha në Greqi, por tani dua të shijoj rehatinë e të qenit në shtëpinë time (Ledi, 51).

Disa nga këta migrantë zotëronin tashmë prona në Shqipëri, të trashëguara nga prindërit e tyre. Ata dëshironin të kishin një jetë më të qetë dhe të rehatshme në vendin e tyre dhe trashëgimia e një prone nga familjarët përshpejtoi vendimin e kthimit në vendlindje.

### 5.1.3 ARSYET FAMILJARE

Disa nga arsyet e tjera të kthimit kishin të bënin me detyrimet familjare dhe në radhë të parë detyrimi për t'u kujdesur për brezin e vjetër. Përkeqësimi i gjendjes shëndetësore të prindërve në vendlindje dhe nevoja e tyre për kujdes të vazhdueshëm nga fëmijët, ndikoi deri diku në vendimet e tyre për t'u kthyer. Disa migrantë të kthyer i kishin lënë fëmijët e tyre nën përkujdesjen e prindërve të tyre, me shpresën për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme. Megjithatë, orët e gjata të punës, largësia dhe malli për fëmijët i shtynë të kthehen. Në raste të tjera, statusi si emigrantë të parregullt krijonte shumë pak gjasa për ribashkim me fëmijët apo prindërit e tyre në Greqi. Për shembull:

[Unë e vizitoj Shqipërinë shumë shpesh sepse] prindërit e mi jetojnë atje. Aty shkojnë edhe fëmijët e mi në shkollë dhe vetëm gjatë pushimeve verore vijnë [në Greqi] dhe më ndihmojnë në tavernë. Sa herë që ktheheshim në Shqipëri çdo dimër, duhej t'i hiqim nga shkolla dhe t'i regjistrojmë këtu, gjë që na shkaktonte shumë telashe. Më në fund, fëmijët u rritën dhe unë nuk mund t'i lija më vetëm. Ata janë arsyeja kryesore që u ktheva. [...] Gjithashtu, u lodhëm duke punuar rreth 16 orë në ditë në tavernë. Ne nuk u prekëm nga kriza sepse kishim ende shumë punë. [...] Marrja e dokumenteve doli të ishte pak e ndërlikuar. Kanë kaluar më shumë se katër vjet që kur jam kthyer, por vazhdoj të kthehem për tre muaj kur është sezoni i pikut (Aldo, 53).

Historitë jetësore dhe reflektimet e ndara nga shumë migrantë vënë në dukje shqetësimet që ata kishin edhe për prindërit e tyre. Të dhënat e përfituara nga analiza cilësore tregojnë se ekziston një lidhje e fortë me familjen dhe anëtarët farefisnorë, prindërit dhe atdheun në përgjithësi. Edhe pse një i intervistuar i kishte marrë prindërit e tij në Greqi, ata nuk ndiheshin rehat të jetonin në një vend të huaj, pavarësisht nga numri i madh i migrantëve shqiptar që jetonin atje. Brezi i vjetër ishte më rezistent ndaj idesë së qëndrimit në një vend të huaj. Ata shprehën shqetësimin për pronat e tyre në Shqipëri, në të cilat kishin investuar fitimet e tyre. Vlen të theksohet se disa migrantë shprehën shqetësimin që ato kishin dhe detyrën për t'u kujdesur për prindërit e tyre:

Unë jam djali i vetëm dhe motrat e mia janë të dyja të martuara. Kështu që vetëm unë duhet të kujdesem për prindërit tanë. I solla në Greqi dy ose tre herë, por më e gjata që mund të qëndronin ishte dy ose tre javë. Aty pranë kishte shumë shqiptar që të shoqëroheshin me ta, por ata ishin mësuar me komoditetin e vendlindjes. Ne jetojmë në një fshat midis Korçës dhe Maliqit ku kemi investuar në një shtëpi të madhe. Babai im kishte frikë se shtëpia do të prishej nëse ata nuk do të jetonin atje, ndaj duhej të qëndronin në Shqipëri. Nuk mundëm t'i bënim të qëndronin në Greqi, ndaj u detyruam të ktheheshim për t'u kujdesur për ta (Dardani, 38 vjeç).

Siç mund të kuptohet nga citimet e përmendura më sipër, rruga e kthimit u formësuan në një farë mase

nga dëshirat dhe detyrimet e tyre kundrejt familjeve të tyre.

#### 5.1.4 VULLNETI I LIRË - ARRITJA E QËLLIMEVE TË MIGRACIONIT

Së fundmi, një grup tjetër migrantësh, që ne intervistuar ishin ata që kishin grumbulluar mjaftueshëm fitime dhe kishin menduar të investonin në Shqipëri. Ky grup duket se ka shumë potencial për sa i përket kapitalit financiar, social dhe njerëzor, pasi kthimi i tyre ishte tërësisht vullnetar dhe jo domosdoshmërisht i kushtëzuar nga kriza ekonomike apo faktorë të tjerë të lidhur me familjen. Trajektorja e këtyre migrantëve përbën atë që mund të shihet si histori suksesi ose siç theksojnë Gedeshi dhe King (2018), ata që kanë arritur qëllimet e tyre fillestare të migrimit.

Një i intervistuar, për shembull, vuri në dukje faktin se në Shqipëri kishte mundësi për hapjen e një sipërmarrjeje e cila mund të kërkonte një investim me më pak kapital sesa nëse në Greqi. Për më tepër, ky i intervistuar theksoi se kishte ardhur koha që të mos punonte më në kushte të vështira fizike (d.m.th., ndërtim) në Greqi, gjë që kishte filluar t'i dëmtonte shëndetin. Kthimi në Shqipëri ishte një vendim me rrezik më të ulët për të, pasi mund të rikthehej në punë ose të fillonte një biznes të ri përmes lidhjeve. Aurora, një e kthyer në Voskopojë, pohon:

Si shumica e shqiptarëve atje, edhe ne ishim të prekur nga kriza ekonomike, por bashkëshorti im arrinte të gjente sadopak punë nëpërmjet lidhjeve të tij. Ndërsa unë mund të punësohesha menjëherë nëse do të kthehesha apo të hapja një biznes të ri me të gjitha aftësitë dhe njohuritë që fitova jashtë vendit. Vëllezërit e motrat erdhën për të na vizituar në Greqi dhe na sugjeruan se në Voskopojë kishin nevojë për një biznes të tillë (furrë buke). Ne e morëm në konsideratë këtë gjë, sepse im shoq ishte lodhur duke punuar në ndërtim. Ishte koha të kthehesha dhe të investoja në vendin tim (Aurora, 40).

## 5.2 POTENCIALI PËR INVESTIM PAS KTHIMIT

Ruajtja e lidhjeve ndërpersonale dhe familjare me vendin e origjinës lehtësoi vendimin për t'u rikthyer dhe krijoi premiset për investime kapitale. Është me vlerë të theksohet se të dhënat tona empirike sugjerojnë se migracioni i kthimit nuk ishte një vendim domosdoshmërisht i përhershëm, por një cikël qarkullues që përfshin episode të shumta migrimi para kthimit final. Prirja për të ngritur dhe menaxhuar një biznes duket të jetë një opsion i pëlqyeshëm për ata që dëshirojnë të transferojnë kapitalin e fituar jashtë vendit. Rrëfimet tona tregojnë se disa migrantë kishin zhvilluar tashmë paraprakisht një plan investimi dhe menaxhimi biznesi:

Ne u kthëm sepse shtëpia e familjes sonë ishte atje. Voskopoja filloi të zhvillohej gradualisht. Unë kthehesha pothuajse çdo tre javë në Shqipëri. Të premteve udhëtoja me autobus dhe të hënën kthehesha në punë në Greqi. Sa herë që kthehesha në shtëpi për pushime, mendoja të investoja kursimet tona dhe të kisha diçka tonën, që do të ishte më mirë sesa të punoja për dikë tjetër. Ky ishte motivimi im kryesor. [...] Unë nuk e diskutova idenë time të biznesit me asnjë nga të afërmit e mi që jetonin këtu. Ishte një vendim i palëkundur (Drini, 44).

Bleva shtëpinë dhe mendova se e vetmja mënyrë për të jetuar këtu do të ishte ta shndërroja në një bujtinë. [...] Unë bëra gjithçka vetë, duke i përfunduar dhomat një e nga një (Denaldi, 53).

Nuk e kisha menduar se ku doja të punoja pas kthimit në Shqipëri, sepse kam përfunduar vetëm shkollën e mesme. Unë nuk kam një profesion. Më së shumti shpresoja të hapja një biznes të vogël, një bar kafe ose një restorant të vogël. Kam grumbulluar përvojë të mjaftueshme për të mbijetuar në treg. [...] Nuk kisha menduar për ndonjë plan tjetër biznesi apo investime. Do të ishte ose një bar kafe ose restorant, ose një fermë pulash (Sajmiri, 46).

Rrëfimet tregojnë se sipërmarrjet e biznesit ishin të fokusuar kryesisht në turizëm dhe bujqësi për shkak të mungesës së përvojës dhe mundësi të tjera biznesi. Këto biznese u zhvilluan ngadalë përgjatë viteve, pasi migrantët e kthyer filluan të kursejnë dhe

investojnë në shtëpitë e tyre vit pas viti.

Ne vërejtëm se network-u social shërbeu si një mekanizëm sigurie për të garantuar riintegrimin në tregun e punës të të kthyerve në mungesë të burimeve të tjera mbështetëse. Networku familjar ishte i dobishëm duke ndihmuar migrantët me informacion ose duke lehtësuar hyrjen e tyre në tregun e punës. Të njohurit e migrantëve të kthyer kishin hapur biznese të ngjashme në sektorin e hotelerisë dhe turizmit. Ata asistuan të kthyerit përmes dhënies së informacionit mbi tregun e punës, mundësive për investim, informacionit mbi procedurat ligjore dhe ato të hapës së kompanive në Shqipëri, këshillimit mbi rreziqet që lidheshin me hapjen e sipërmarrjeve, etj.

Vija këtu 2-3 herë në muaj dhe e dija se çfarë ndodhte këtu. Vinim pesë herë në vit. Për shembull, kunati im erdhi nga Greqia dhe kishte një tavernë atje pak më tutje. Gruaja ime filloi biznesin dhe i ndihmoi ata me gatimin. [...] Në vitin 1994 hapëm një dyqan të vogël dhe më pas e zgjeruam me kalimin e viteve. Miqtë tanë të familjes erdhën për të na vizituar dhe na sugjeruan këtë ide. Ata na dhanë shumë informacion në lidhje me procedurat e hapjes së biznesit (Miri, 45).



# VI. SFIDAT E RIINTEGRIMIT NË TREGUN E PUNËS

Eksperiencat e mëparshme të punës në sektorin e ndërtimit apo hotelierisë kishin ndihmuar që emigrantët të përfitonin mjaftueshëm njohuri dhe aftësi, të cilat do t'i investonin në vendlindje. Ndër të tjera, ata ishin pajisur me ide më përparimtare se si të hapnin dhe menaxhonin një biznes. Përveç aftësive teknike në sektorë të veçantë, si kulinari apo ndërtim ata ishin më të avancuar në përdorimin e teknologjive moderne si dhe promovimin e një kulture të re pune.

## 6.1 MBËSHTETJA DHE NDIHMA PËR RIINTEGRIM NGA SHETI

Mbështetja për riintegrimin është element kyç në ripërfshirjen e të kthyerve në tregun e punës. Sa i përket mbështetjes institucionale, të kthyerit deklarojnë se nuk kanë informacion mbi programet mbështetëse. Siç thotë Meri, 41 vjeç: “Nuk jam në dijeni që ka institucione që ofrojnë ndihmë. Nuk kam informacion për këtë dhe as kam lexuar gjëkund për të”. Të kthyerit e kanë të vështirë të përshtaten me tregun e punës, megjithëse përvoja e tyre i ka pajisur ata me njohuri teknike ‘know-how’, aftësi dhe kompetenca, duke u dhënë atyre një avantazh konkurrues. Përveç kësaj, ata pohojnë se njohuritë e marra jashtë vendit ndonjëherë nuk ishin praktike dhe jo aq të vlerësuara sa duhet. Nela, një grua 50-vjeçare, shprehet: “E kisha të vështirë të përshtatesha me tregun e punës, edhe pse isha e gatshme për të punuar kudo, në fillim ndjeva se nuk vlerësohej përvoja ime. Komunikimi dhe kontaktet me institucionet qeveritare ishin mjaft sfiduese. Madje edhe për gjëra të parëndësishme si marrja e një certifikate të thjeshtë, mezi përgjigjeshin”.

Nga ana tjetër, qeveria qendrore ka shpallur disa skema mbështetëse për riintegrimin në tregun e punës të migrantëve të kthyer. Megjithatë, shumica e migrantëve të kthyer deklarojnë se nuk kanë marrë asnjë mbështetje apo ndihmë konkrete. “Ne kemi dëgjuar për programet e ndihmës dhe riintegrimin të qeverisë, por vetëm teorikisht. Praktikisht, nuk kemi përfituar asnjë nga këto” -pohon Ilda, një grua 34-vjeçare. Ata deklarojnë se nuk gjejnë dot një mënyrë për t’iu qasur këtyre programeve, madje disa nuk janë të sigurt nëse ato ekzistojnë. Migrantë të tjerë përmendën të njëjtën gjë:

“Duke qenë se jam intelektual, kërkova programe riintegrimi, por nuk gjeta edhe pse më parë kam mbajtur poste të rëndësishme. Kjo është arsyeja pse vitin e parë pasi u ktheva, u punësova në një kompani tjetër dhe vajta në Maqedoninë e Veriut” (Sandri, 53).

“Nuk jam i sigurt nëse ka apo jo ndonjë program riintegrimi në Shqipëri pasi duhet t’i kërkosh, por unë vetë nuk kam marrë asnjë lloj mbështetjeje apo ndihme. [...] Jo, nuk jam kontaktuar nga ambasada dhe as nga ndonjë institucion tjetër” (Sajmiri, 46).

Siç u identifikua më parë në këtë studim, shumica e të kthyerve investuan në hapjen e një biznesi pas kthimit. Sipërmarrja ishte potencialisht një sektor ku ata mund të investonin me aftësitë, ekspertizën dhe njohuritë e tyre teknike (know-how) të grumbulluara në vendin pritës. Megjithatë, pothuajse të gjithë migrantët e kthyer deklaruan se nuk kishin marrë ndonjë incentivë financiare nga qeveria për start-up-et e tyre. Siç kujton një pjesëmarrës:

“Ne e ngritëm biznesin tonë nga e para, pa ndihmën e askujt. Bashkëshorti dhe babai im filluan të ndërtonin shtëpinë. Vëllai im vinte ndonjëherë dhe i ndihmonte. Më pas, filluam të blinin gjërat që na duheshin për furrën e bukës. Ne kemi marrë gjithçka vetë. Kur mbaruam së pajisuri furrën, ndërtuam një shtëpi tjetër dhe e dhamë me qira (Aurora, 40).



Të tjerë vunë në dukje të njëjtat probleme:

Nuk kam kërkuar mbështetje financiare nga shteti. Gjithçka që më duhej, e kisha tashmë vetë, ose kisha familjen që më mbështeste (Andi, 41 vjeç).

Kam dëgjuar për zyrat e migracionit, por nuk kam aplikuar kurrë. Familja ime ka qenë e vetmja që më ka mbështetur. Qeveria na dha vetëm pagën e kompensimit për periudhën e karantinës. Por, si migrantë të kthyer, nuk kemi marrë asgjë (Dario, 30 vjeç).

Është me vend të theksohet fakti se pak pjesëmarrës pretendojnë se organizatat e shoqërisë civile kanë qenë e vetmja mbështetje për riintegrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Kjo mbështetje u fokusua kryesisht në asistencën e menaxhimit të bizneseve dhe në aspekte të ndryshme të promovimit të biznesit dhe komunikimit. Rasti i mëposhtëm ofron një ilustrim të mirë të një mbështetjeje të tillë:

[...] E vetmja mbështetje që kemi marrë është nga disa organizata të shoqërisë civile që reklamuan online bujtinat e Voskopojës dhe kaq. Ndërkohë në veri ka pasur shumë investime. Në Theth, për shembull, kanë shpërndarë edhe para kesh! Ndërsa unë çdo gjë e bëj vetë. Unë paguaj taksat e shtëpisë, të bashkisë dhe gjithçka tjetër (Denaldi, 53).

Mbështetja gjatë situatës së pandemisë ishte një fushë tjetër me interes për këtë studim. Në përgjithësi, nuk kishte ndonjë mbështetje të dedikuar për biznesin e tyre. Për të regjistruarit, qeveria ofroi paketa stimuluese financiare njësoj si për të gjitha kompanitë e tjera në Shqipëri. Citimet e mëposhtme ilustrojnë mbështetjen që ata kanë marrë:

Jo, nuk ka pasur dëmshpërblime nga qeveria. Për më tepër, pandemia nuk na preku aq shumë sepse kemi një furrë buke. Por ata na dhanë 40000 lekë për lokalin (Aurora, 40).

Qeveria jo vetëm që nuk na mbështet, por madje përpiqet edhe të na sulmojë. Gjithçka e kam bërë vetë, pa ndihmën e askujt (Alba, 24).

Nuk kemi marrë asnjë dëmshpërblim nga shteti

për periudhën e karantinës, sepse atëherë nuk ishim të regjistruar. Megjithatë, disa njerëz të zonës e bënë këtë. Tani që morëm licencën, na mjafton puna që kemi (Beni, 58 vjeç).

Të kthyerit raportuan se nuk kishin marrë asnjë mbështetje nga shteti për ngritjen e bizneseve të tyre, madje nuk kishte mundur as aksesin në shërbimet bazë, siç është furnizimi me energji elektrike dhe ujë. Jo vetëm kaq, por të tjerë u përballën me vështirësi në njohjen e dokumenteve dhe letrave që lidhen me biznesin e tyre.

## 6.2 SFIDAT NË NGRITJEN DHE MENAXHIMIN E NJË BIZNESI

Të intervistuarit theksuan se suksesi i një sipërmarrjeje në Shqipëri varet kryesisht nga faktorë të jashtëm si : ndërmjetësimi, njohjet ose lidhjet që një sipërmarrës ka si dhe nga klima e biznesit në përgjithësi. Bizneset operojnë në një mjedis që përfshin faktorë makro dhe mikro. Pra, është thelbësore të menaxhohen faktorët, që vijnë nga makromjedisi, që lidhen me situatën ekonomike, mjedisin politik dhe ligjor, mjedisin social etj. Nëse mundësohen kushte të përshtatshme dhe të favorshme, biznesi do të ketë më shumë shanse për të qenë i suksesshëm. Në studimin tonë, kjo klimë nuk është aq inkurajuese sa për të zhvilluar biznese të suksesshme. Të intervistuar vunë në dukje faktin se **procedurat burokratike** ishin një nga sfidat kryesore me të cilat pjesa më e madhe e migrantëve të kthyer janë përballur:

Jo, nuk kam marrë asnjë mbështetje nga shteti. Kam kërkuar leje nga bashkia, por nuk kam marrë asnjë ndihmë në këmbim. Nuk më jepnin as energji elektrike. Kërkonin që unë të hapja biznesin, të merrja një licencë dhe vetëm atëherë të më jepnin energji elektrike. Ky ishte një proces mjaft i gjatë (Andi, 41).

Të anketuar të tjerë theksuan se procedurat burokratike në **njohjen e certifikatave të mëparshme të trajnimit**, ishin një tjetër pengesë:

Ata (emri i institucionit të nivelit kryesor) nuk ma njohën as certifikatën për shkak të procedurave



burokratike. Por pa certifikatën e kuzhinierit, nuk më lejohej të filloja biznesin. Pra, më duhej të bëja një kurs këtu edhe pse 25 vite guzhinier në Greqi. Ne kemi një dosje në të cilën ruaj të gjitha dokumentet që lidhen me kompaninë. Ushqimet e hedhura, trajnimet që kryhen çdo muaj, skedari i dezinfektimit, regjistri i menaxhimit të mbetjeve, regjistri për pastrimin e pajisjeve etj. Të gjitha këto janë të kota (Dardani, 38).

Migrantët e kthyer janë të zhgënjyer me politikat dhe masat e institucioneve që supozohet t'i ndihmojnë ata financiarisht në ngritjen e një biznesi. Ata shprehen, se ndonëse sektori ku kanë investuar është prioritar për zhvillimin e turizmit në vend, ata nuk kanë marrë asnjë kredi të butë të akorduar për nxitjen e investimeve në atë sektor. Përkundrazi, disa prej tyre deklaruan se ishin përballur me një mungesë transparence në lidhje me mënyrën dhe procedurat e kredive të buta. Më poshtë disa shembuj:

Nuk kam pasur asnjë mbështetje nga institucionet, as kredi të buta, asgjë. Mbaj mend që kam dëgjuar për një program, por dukej se ata ishin më të interesuar për fitimet e tyre sesa për të më ndihmuar mua. Kështu që e nisa vetë ndërtimin vitin e kaluar në mars dhe e hapa në nëntor. [...] Jo, nuk kam aplikuar për këtë program apo ndonjë program tjetër. Isha shumë i zhgënjyer nga [emri i institucionit] dhe nuk doja të kisha të bëja më me ta (Ledi, 47).

Nëse do të kisha marrë një kredi të butë me emrin (emri i programit), do ta kisha blerë këtë. Por, kur përfaqësuesit e programit u shfaqën në pragun tim, më kërkuan "kafen" pa nisur as procesin. Pavarësisht nëse kredia do të miratohej apo jo, ata ende donin pjesën e tyre. Nëse aplikon, ata të financojnë deri në 60% të vlerës totale, dhe ti mund të marrësh deri në 450.000 Euro. Sapo dëgjova për "kafen", nuk aplikova fare. Nuk isha mësuar të jepja ryshfet në Greqi (Dardan, 38).

Jo, nuk kam marrë asnjë ndihmë apo kredi të butë nga qeveria. Gjithçka e nisa me një borxh prej 40000 lekësh dhe për fat, në ditët e sotme jam mjaft mirë. Unë paguaj çdo qindarkë detyrime që kam në taksat! Shteti nuk na jep asgjë në këmbim; për më tepër të bëjnë edhe presion për t'i votuar, ose në të kundërt të falimentojnë. Njerëzit tanë ishin të vetmit që na mbështetën, jo qeveria. (Berti, 55 vjeç).

Siç shihet edhe nga intervistat tona, ankesat lidhen kryesisht me korrupsionin, sistemin tatimor, si taksat e larta, ngarkesat fiskale dhe administrative, rregullat e paqëndrueshme tatimore, ndryshimet e shpeshta të politikave tatimore dhe procedurat komplekse tatimore, si dhe qasja në kredi dhe konkurrenca e pandershme.

### 6.3 KLIMA JO E FAVORSHME E BIZNESIT

**Rregullat strikte** dhe sjellja e orientuar drejt ndëshkimit nga autoritetet janë gjithashtu pengesa të tjera për funksionimin e efektiv të biznesit të të kthyerve:

Ata nuk e kanë ndjenjën e bashkëpunimit dhe sinergjisë ndaj së cilës u ekspozuan kur jetonin në vendin fqinj. Jo vetëm kaq, por ata janë ndeshur me një mjedis jo miqësor, gjë që sipas tyre shpjegohet me një kërkesë të fshehtë të autoriteteve për të fituar para nga biznesi (Genti, 36).

Nuk isha mësuar të jepja ryshfet në Greqi. Edhe nëse autoriteti tatimor do të kontrollonte biznesin tim në Greqi dhe do të identifikonte ndonjë problem, ata do të më paralajmëronin me dashamirësi dhe do të më udhëzonin të kontaktoja kontabilistin tim për të mos u gjeditur. Ndërkohë në Shqipëri mund t'ju pushojnë madje pa shkelur fare në ambientet e biznesit tuaj. Në Greqi, institucionet qeveritare ishin të dobishme: gjithmonë përpiqeshin të informonin paraprakisht. Jo vetëm që është e paimagjineshme ta bëjmë këtë këtu, por ne paguajmë sigurime për të gjithë punonjësit tanë dhe prap hasim burokraci (Donaldi, 53).

Të kthyerit nuk ndihen të sigurt për investimet dhe pronat e tyre. Çështja lidhet me faktin se në disa bashki ka ende probleme me pronarët e tokave dhe **certifikatat e pronësisë**. Mospajisja me certifikatat e pronësisë do të thotë vështirësi në lidhje me investimet e mundshme në të ardhmen, të cilat mund të jenë thelbësore për të përmirësuar funksionalitetin dhe përdorimin e duhur të pronës. Pra, të kthyerit deklarojnë se për shkak të kësaj situatë kanë qenë të detyruar të thyejnë rregullat dhe të investojnë në pronat e tyre pa **leje**.

Kur u kthjem për herë të parë, situata ishte pak më ndryshe. Një nga problemet kryesore në Voskopojë është mosdhënia e lejeve të ndërtimit, gjë që na ka shkaktuar shumë probleme. Edhe sot e kësaj dite nuk e kemi lejen e ndërtimit. Ne vërtet kemi ndërtuar, por pa leje. E vetmja gjë që kemi është certifikata e tokës. Ofruesi i energjisë elektrike kërkonte një leje të vlefshme ndërtimi. Përndryshe, nuk të firmoste kontratë për energjinë elektrike (Andi, 41 vjeç).

Problemi më i madh këtu është marrja e një leje ndërtimi. Ne (unë dhe familja ime) u përballëm me disa probleme pasi u kthjem. Së pari, në lidhje me kulturën dhe integritetin, çështjet sociale dhe ndërveprimet me administratën publike: ata nuk ishin në gjendje të na ofronin asnjë shërbim apo të përpiqeshin të kuptonin atë që ne kërkonim (Sandëri, 53).

Në historitë e shumë migrantëve mbizotëronte **pasiguria mbi të drejtat e tokës dhe pronës**, së bashku me **boshllëqet në infrastrukturën publike** (mosbesueshmëria, probleme të furnizimit me energji; infrastrukturë e dobët për vaditjen). Përveç kësaj, disa prej tyre ishin të shqetësuar edhe për mungesën e aftësive dhe mospërputhjet në tregun e punës, pasi nuk mund të gjenin punëtorë të kualifikuar. Klima jo e favorshme e biznesit pengon deri diku investimet e huaja nga të kthyerit, të cilat duket se janë kyçe në rritjen e konkurrencës së ekonomisë.

Ata ishin mjaft të zhgënjyer, pasi jo vetëm nuk kishin asnjë stimul, por përkundrazi, pretendonin

se autoritetet i bënin kontrolle në një masë më të madhe në krahasim me bizneset e tjera. Përpos vështirësive, disa migrantë të kthyer nga Italia kishin krijuar tashmë partneritete ekonomike transnacionale, duke investuar në futjen e teknologjive moderne dhe promovimin e një etike të re pune. Megjithatë, ata pohuan se nuk kishin gjetur mbështetjen e duhur nga qeveria.

Shumica e pjesëmarrësve në këtë studim theksuan se ishin përballur me pengesa të shumta administrative dhe institucionale për shkak të procedurave burokratike, korrupsionit, taksave të larta, informalitetit dhe konkurrencës së pandershme. Për më tepër, paqëndrueshmëria e sistemit politik dhe ekonomik ka penguar më tej përpjekjet e tyre për hapjen e biznesit. Pjesa dërmuese e tyre ndiheshin të zhgënjyer dhe të penduar për investimin që kishin bërë në Shqipëri:

Më vjen keq që u ktheva, por mu desh ta bëja për shkak të prindërve të mi. Edhe pse aty punoja rreth 16 orë në ditë, ndihesha më rehat. Nuk bëhesha me dhimbje koke. Merrja të gjithë rrogën në fund të muajit; Paguaja taksat, dritat, qira etj. Dhe prapë më kushtonte më pak se sa më kushton këtu. Ndërkohë, këtu duhet të paguajmë për çdo shërbim. Për të blerë ujë, çdo muaj kushton afërsisht 90000 lekë. Për të mos folur për lodhjen mendore të shkaktuar nga ora policore (Drini, 44).

## VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Vitet e fundit, Shqipëria është përballur me një fluks relativisht të lartë të migracionit të kthimit, kurba e të cilit është rritur ndjeshëm si pasojë e krizës ekonomike globale. Për shkak të recesionit të thellë ekonomik, situata financiare e familjeve migrante shqiptare në dy vendet kryesore pritëse të migrantëve shqiptarë si Greqi dhe Itali, u përkeqësua për shkak të uljes së të ardhurave dhe rritjes së nivelit të papunësisë. Rritja e paprecedentë e nivelit të papunësisë i zhyti këto familje në vështirësi të mëdha financiare. Kriza ekonomike ishte një ndër faktorët kryesor që motivoi kthimin e migrantëve në vendlindje.

Pavarësisht faktorëve tërheqës dhe shtytës që përshpejtuan kthimin nga migracioni, pothuajse të gjithë të intervistuarit deklaruan se u përballën me një numër të madh sfidash pasi u kthyen dhe veçanërisht në riintegrimin në tregun e punës. Studimi ynë evidentoi se asnjë nga të kthyerit nuk ka akeluar sportelet e migracionit pasi nuk ishin në dijeni të mekanizmave të tillë. Të kthyerit u hasën me vështirësi të shumta për sa i përket aksesit në informacion, orientimit dhe udhëzimeve rreth sektorëve të mundshëm ku mund të investonin kursimet e tyre. Intervistat nxorën në pah faktin që ata kishin fare pak informacion në lidhje me politikat dhe legjislacionin vendas për hapjen e një biznesi ose aksesin në shërbimet publike. Familjarët dhe miqtë e tyre ishin burimet kryesore të informacionet për ta.

Megjithëse klima e biznesit është e një rëndësie të madhe për investitorët privatë, gjetjet sugjerojnë se të kthyerit e perceptojnë klimën e biznesit në Shqipëri si të pafavorshme për zhvillimin e suksesshëm të biznesit të tyre. Politikat për tërheqjen e investimeve (të huaja) nuk bëjnë dallime ndërmjet sipërmarrësve migrantë ose investitorëve (të huaj). Edhe pse në kuadër të menaxhimit të biznesit, kjo lidhet me konkurrencën e biznesit në treg, të kthyerit ndiheshin të zhgënjyer me politika të tilla.

Shumica e të intervistuarve deklaruan se burokracia, informaliteti i përhapur dhe korrupsioni kishin qenë pengesat kryesore për riintegrimin në tregun e punës. Ata u përballën me vështirësi në aksesin dhe paisjen me dokumentacionin e

nevojshëm. Gjithashtu, mungesa e infrastrukturës në vend, investimet e pakta publike dhe procedurat jotransparente të biznesit në lidhje me investimet dhe kreditë e buta, u perceptuan si pengesa kryesore për riintegrimin e tyre të suksesshëm në tregun e punës. Informacioni i disponueshëm për të kthyerit dhe ofrimi shërbimeve mbeten shumë larg standardit të dëshiruar. Shërbime të tilla ishin tejet të fragmentuara ose në raste të veçanta të bazuara në projekte.

Përveç kësaj, asnjëri prej tyre nuk kishte marrë ndihmë financiare apo kishte përfituar nga paketa stimuluese pas kthimit. Ata shprehën shqetësimin e tyre sa i përket favorizimit për ofrimin e stimujve të tillë. Pas pandemisë së COVID-19, disa investitorë ishin të shqetësuar nëse do të mund t'ja dilnin të mbijetonin me biznesin e tyre. Intervistat pasqyronin një retorikë negative nga të kthyerit të cilët jo rrallë herë shprehnin keqardhje për faktin se kishin investuar në Shqipëri. Ndjesitë e zhgënjimit dhe pendesës ishin të pranishme te të gjithë ata që kishin investuar në Shqipëri.

Edhe pse për disa të intervistuar kthimi perceptohej si një vendim përfundimtar, për shumë të tjerë kthimi ishte i përkohshëm. Kjo mund të lidhet edhe me modelet e migracionit qarkullues shqiptar, të cilat përbëhen nga shumë lëvizje të shpeshta ciklike midis vendit të origjinës dhe vendeve pritëse. Megjithatë, mungesa e politikave të riintegrimin dhe humbja e perspektivës për të ardhmen në vend, rrisin gjasat e migrimit potencial nga të kthyerit (INSTAT & IOM, 2014). Sipas të intervistuarve, migracioni i kthimit shihej si një ndërprerje e planeve dhe ambicieve migratore përballë vështirësive ekonomike dhe jo si pikë përfundimtare e trajektores së tyre të lëvizjes. Ky grup migrantësh ndihej mjaft i pasigurt për të ardhmen e tyre në Shqipëri.

Vlen të theksohet se një rikthim i tillë i parakohshëm i migrantëve në vazhden e krizës financiare nuk u shoqërua me akumulimin e kapitalit të nevojshëm social dhe ekonomik në vijim të kthimit në vendin e origjinës. Nga ana tjetër, ata që ishin përgatitur paraprakisht për rikthimin e tyre dhe që kishin një orientim dhe plan investimi duket se ishin më të qëndrueshëm ekonomikisht pas kthimit. Ky grup i

migrantëve kishte predispozitë më të lartë për të mbajtur lidhje të forta familjare dhe farefisnore duke vizituar shpesh Shqipërinë ose duke përdorur mjete komunikimi nëpërmjet mediave sociale. Studimi ynë evidentoi se të kthyerit që përmbushën deri diku objektivat e tyre migratore kishin më shumë gjasa të konsideroheshin investitorë potencialë dhe agjentë të zhvillimit ekonomik. Ata ishin në gjendje të vinin në funksion aftësitë që fituan jashtë vendit dhe, si të tillë, kishin perspektiva më të mira punësimi në Shqipëri.

Gjetjet tona sugjerojnë se infrastruktura e riintegritimit dhe faktorët strukturorë kanë formësuar modelet e paskthimit në tregun e punës. Faktorë të tillë janë ndër kushtet e nevojshme për nxitjen e investimit të kapitalit, aftësive dhe njohurive të fituara jashtë vendit. Vlen të përmendet se përgatitja para kthimit zë një peshë të madhe në përvojat pas kthimit, një gjetje në përputhje me studimet e tjera kërkimore në këtë fushë (Mähönen dhe Jasinskaja-Lahti, 2012; Cena & Heim, 2021).

Si përfundim, studimi aktual kontribuon në analizimin e faktorëve dhe aktorëve që formojnë dhe pengojnë modelet e riintegritimit në tregun e punës. Ndonëse nuk ka një zgjidhje të vetme apo universale për të adresuar sfidat e riintegritimit të migrantëve të kthyer në tregun e punës, një qasje gjithëpërfshirëse është e nevojshme për të adresuar nevojat e tyre komplekse. Dështimi për të adresuar nevojat e menjëhershme të riintegritimit të të kthyerve përmes krijimit të një politike efikase dhe kornizës institucionale mund të përkeqësojë më tej potencialin e tyre zhvillimor. Prandaj, për të përfutur nga potenciali i të kthyerve dhe për të shfrytëzuar njohuritë e tyre teknike (know-how) për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, i gjithë cikli i riintegritimit duhet të fuqizohet dhe të bëhet më efikas nëpërmjet rekomandimeve dhe nxitjes së politikave të mëposhtme.

## AKSESI NË INFORMACION DHE RITJIA E NDËRGJEGJËSIMIT

Duke pasur parasysh ndryshimet e konsiderueshme në vendin e origjinës, është me rëndësi parësore informimi i migrantëve të kthyer në lidhje me kuadrin legjislativ të vendit, punësimin dhe mundësitë e biznesit privat. Për të arritur këtë qëllim, duhet të ndërmerren masat e mëposhtme:

- » Rritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të qendrave të informacionit (sportelet e migracionit-SM) për të ofruar mbështetje dhe këshillim; përshkallëzimi dhe vënia në punë e SM-ve në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për të siguruar një mbulim më të mirë të grupit të synuar; SM-të duhet të lehtësojë dhënien e informacionit mbi legjislacionin vendas; informacion mbi shërbimet mjekësore, programet sociale, sigurimin e pensionit dhe dokumentet që lidhen me shtetësinë; si dhe informacion praktik për mundësitë e investimeve dhe tregun e punës në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme;
- » Zhvillimi dhe promovimi i një portali që ofron informacion tërësor për migrantët e kthyer;
- » Rritja e ndërgjegjësimit për shërbimet e disponueshme për migrantët e kthyer përmes broshurave informative në aeroporte, bashki, qendra shëndetësore, shkolla dhe institucione të tjera (si ADISA) për t'u siguruar që ata janë të mirinformuar për shërbime të tilla;
- » Sigurimi sistematik i informacionit dhe shpërndarja e të dhënave të migracionit të kthimit nga autoritetet përkatëse;
- » Mjete efektive të komunikimit dhe advokimit për të informuar, ndikuar ose rritur ndërgjegjësimin e zyrtarëve publik, mediave dhe aktorëve të tjerë kyç të përfshirë në çështjet që kanë të bëjnë me të kthyerit.

## PËRFSHIRJA NË TREGUN E PUNËS

Trajtimi i çështjes së punësimit është një hap thelbësor në riintegritimin e të kthyerve në vendin e tyre të origjinës për të siguruar pavarësinë e tyre financiare.

- » Zhvillimi i programeve specifike të nxitjes së punësimit që maksimizojnë kapitalin njerëzor të të kthyerve dhe ofrojnë stimuj për profilizimin e tyre në sektorë të veçantë të ekonomisë;
- » Zhvillimi i trajnimeve dhe workshop-e për rikualifikimin dhe diversifikimin e aftësive të të kthyerve sipas nevojave të tregut vendas të punës;
- » Përmirësimi i procedurave për njehsimin e njohurive dhe lehtësimin e procesit për njohjen

e certifikatave të arsimit/AFP-së të marra jashtë vendit;

- » Mbështetje për punësim dhe nxitja e programeve për të rritur perspektivat e punësimit të të kthyerve; ndërlidhjen me operatorët privatë për ofrimin e programeve të punësimit/stazhit;
- » Nxitja dhe promovimi i stimujve financiarë ose teknike për kompanitë që punësojnë të kthyerit.

#### **MBËSHTETJA E NISMAVE SIPËRMARRËSE DHE TË VETËPUNËSIMIT**

- » Promovimi i programeve që mbështesin sipërmarrjen dhe bizneset e reja në sektorë ku migrantët mund të vënë në praktikë aftësitë dhe përvojat e fituara jashtë vendit;
- » Krijimi i një klime biznesi më të favorshme nëpërmjet skemave specifike stimuluese për bizneset që synojnë migrantët e kthyer; institucionet dhe donatorët duhet të ofrojnë mbështetje financiare për projektet premtuese të biznesit dhe start-up-et; nxitja e politikave të favorshme fiskale, lehtësirave doganore, asistencës teknike, stimujve financiarë si ulja e taksave dhe kushte më të mira për marrjen e kredisë për ata që krijojnë punësim për të kthyerit;
- » Këshillim afatgjatë dhe asistencë në formë trajnimi për ata që dëshirojnë të investojnë në sektorin e vetëpunësimit;
- » Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe OSHC-ve në partneritet me biznesin për të mbështetur të kthyerit në zhvillimin e planeve të biznesit dhe aplikimin për programe start-up-i, duke i ndihmuar në përgatitjen e planeve të biznesit, menaxhimin financiar dhe atë të biznesit, pagesat e taksave etj;
- » Organizimi i seminareve ndërgjegjësuese në lidhje me legjislacionin në fushën e mikro-sipërmarrjes.

#### **NXITJA E POLITIKAVE DHE PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE PËR MENAXHIMIN E MIGRIMIT TË KTHIMIT DHE RIINTEGRIMIN**

- » Politikat dhe masat për riintegrimin e migrantëve të kthyer duhet të përfshihen plotësisht në dokumente të tjera strategjike ndërsektoriale dhe në planet vendore të veprimit për përfshirjen sociale;
- » Hartimi i një plani të ri veprimi për riintegrimin e të kthyerve për të siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse drejt riintegrimin të tyre në komunitet;
- » Institucionet që punojnë drejtpërdrejtë me migrantët duhet të ndërmarrin periodikisht vlerësime mbi zbatimin e politikave aktuale;
- » Hartimi i një instrumenti për të rishikuar, monitoruar dhe vlerësuar zbatimin dhe efektivitetin e legjislacionit aktual dhe masat për migrimin e kthimit dhe riintegrimin;
- » Migrantët e kthyer duhet të përfshihen si grup përfitues në planet vendore të veprimit dhe dokumentet e tjera strategjike dhe politike të NJVV-ve;
- » Hartimi i udhëzimeve dhe protokolleve për ofruesit e shërbimeve se si t'iu ofrojnë shërbime të kthyerve;
- » Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës për nevojat, kapacitetet dhe boshllëqet në njësitë administrative të prekura nga migracioni i kthimit dhe vlerësimi i potencialeve socio-ekonomike të të kthyerve;
- » Krijimi dhe funksionalizimi i një procedure/ mekanizmi të drejtpërdrejtë dhe efikas në kohë për bashkëpunimin horizontal ndërmjet institucioneve kyçe të përfshira në riintegrimin e të kthyerve, siç janë memorandumet e bashkëpunimit dhe forma të tjera të partneriteteve ndër-institucionale.



# REFERENCAT

- Gemi, E. & Triandafyllidou, A. (2021). *Të rimendosh migracionin dhe kthimin në Evropën Juglindore: Lëvizjet shqiptare drejt dhe nga Italia e Greqia (Ser. Studimi kërkimor i Routledge mbi politikën globale të migracionit)*. Routledge. <https://doi.org/10.4324/9780429344343>
- INSTAT, IOM, CESS. (2020). *Anketa kombëtare e migracionit të familjeve në Shqipëri*. IOM: Tiranë;
- Danaj, S. (2006). *Sfidat e Migrimit të Kthimit dhe Riintegritimit*, Tiranë: Shoqata Shpresa për të Ardhmen;
- García-Pereiro, Th. (2019). *Arsyet për kthimin: një pasqyrë e migracionit të kthimit në Shqipëri*, *Revista e Migracionit Ndërkombëtar dhe Integritimit*, 20(2), 361–374, <https://doi.org/10.1007/s12134-018-0611-z>
- Gedeshi, I. & King, R. (2018), *Tendenca të reja në migrimin e mundshëm nga Shqipëria*, Zyra Friedrich-Ebert-Stiftung : Tiranë;
- Gemi, E. (2014). *Praktikat transnacionale të familjeve shqiptare gjatë krizës greke: papunësia, de-rregullimi dhe kthimi*, *Rishikimi Ndërkombëtar i Sociologjisë*, 24 (3), 406-421;
- Caro, E.(2016). "Unë jam një emigrant në vendin tim": Një profil i shqiptarëve të kthyer nga Greqia, *Revista e Kërkimeve Shkencore dhe Arsimit të Lartë* 1 (1): 9–25. <http://www.ishep-albania.org/wp-content/uploads/2016/06/JSHER-1.pdf>
- INSTAT & IOM .(2014). "Migrimi i Kthimit dhe Riintegritimi në Shqipëri", Tiranë: Instituti i Statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin;
- Labrianidis, L. dhe Lyberaki, A.(2001). *Emigrantët shqiptarë në Selanik*, Selanik: Paratiritis;
- Baldwin-Edwards, M. (2004). "Emigracioni shqiptar dhe tregu grek i punës: simbioza ekonomike dhe paqartësia sociale", *Rishikimi për Evropën Juglindore*, 1(1): 51-66;
- Barjaba, K.(2000). "Modelet bashkëkohore në emigracionin shqiptar", *Rishikimi për Evropën Juglindore*, 3(2): 57-64;
- Vullnetari, J..(2007). "Migrimi dhe zhvillimi shqiptar: rishikimi i gjendjes së artit", *IMISCOE Seria e Letrave të Punës*, Punimet nr. 18, online në [www.imiscoe.org](http://www.imiscoe.org);
- Gialsi, S. (2012). *Integritimi pak kilometra larg atdheut: migrimi i brendshëm i shqiptarëve, vendosja dhe kthimi vullnetar në Epir dhe Ishujt Jon në Greqi*. *Letrat e Migracionit*, 9 (2). 141-154;
- UNDP.(2020). *Forcimi i sistemeve kombëtare dhe lokale për të mbështetur integritimin efektiv socio-ekonomik të të kthyerve në Ballkanin Perëndimor* IPA/2020/420-517;
- IOM .(2015). *Riintegritimi: Qasje efektive*. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin: Gjenevë;
- IOM. (2009). *Ndikimi i krizave financiare në migracionin ndërkombëtar: Mësimet e nxjerra. Seria e Kërkimeve të Migracionit të IOM-it. Nr 37. Organizata Ndërkombëtare e Migracionit*;
- Gedeshi, I. & King, R. (2018). *Studim Kërkimor për Thithjen e Trurit: Përmbysje të procesit të Ikjes së Trurit me diasporën shkencore shqiptare*. Tiranë: UNDP;
- Dustmann, C. dhe O. Kirchkamp. (2002). *Kohëzgjatja optimale e migrimit dhe zgjedhja e aktivitetit pas remigrimit*, *Revista e Ekonomisë së Zhvillimit* 67, nr. 2: 351–72;

- *Ilahi, N. (1999). Migrimi i kthimit dhe ndryshimi i profesionit, Rishikimi i Ekonomisë së Zhvillimit 3, nr. 2: 170–86;*
- *McCormick, B. dhe J. Wahba. (2001). Përvoja e punës jashtë shtetit, kursimet dhe sipërmarrja midis migrantëve të kthyer në vendet më pak të zhvilluara (LDC), Revista Skoceze e Ekonomisë Politike 48, nr. 2: 164–78;*
- *Mesnard, A. (2004) Migrimi i përkohshëm dhe papërsosmëritë e tregut të kapitalit. Dokumentet Ekonomike të Oksfordit 56, nr. 2: 242–62;*
- *King, R. & Vullnetari, J. (2009). Remitancat, kthimi, diaspora: inkuadrimi i debatit në kontekstin e Shqipërisë dhe Kosovës, Gazeta e Studimeve të Evropës Juglindore dhe të Detit të Zi, vëll. 9, nr 4, fq: 385-406;*
- *Kilic, T., Carletto, G., Davis, B. dhe Zezza, A. (2007). "Investimi në vendlindje: Migrimi i kthimit dhe pronësia e biznesit në Shqipëri", Dokumenti i Punës për Hulumtimin e Politikave të Bankës Botërore, Nr. 4366;*
- *Gedeshi, I. dhe Gjokuta, E. (2008). Programi të jetojmë së bashku: Prezantimi i një qyteti emigrantësh. Këshilli Britanik: Tiranë, Shqipëri;*
- *Germenji, E. & Milo, L. (2009). Kthimi dhe statusi i punës në shtëpi: dëshmi nga të kthyerit në Shqipëri, Gazeta e Studimeve të Evropës Juglindore dhe të Detit të Zi, vëll. 9, Nr.4, fq: 497-517;*
- *Maroukis, T. & Gemi, E. (2010). Migracioni Rrethor midis Shqipërisë dhe Greqisë, Projekti Metoikos Instituti Universitar Evropian: Firenze;*
- *Labrianidis, L. & Hatziprokopiou, P.(2005). Cikli i migracionit shqiptar: në fund të fundit migrantët priren të kthehen në vendin e tyre të origjinës. Në King, R., Mai, N., & Schwandner-Sievers, S. (Ed.), Migrimi i Ri Shqiptar (fq. 93-117). Brighton: Shtypi Akademik i Sussex-it;*
- *Nicholson, B., (2001), Nga migrant në mikro-sipërmarrës: bëje vetë zhvillimin në Shqipëri. Shih: Gazeta për Punën dhe Çështjet Sociale në Evropën Lindore, 4(3), 39–41;*
- *Nicholson, B. (2004) "Migrantët si agjentë të zhvillimit: migrantët shqiptar të kthyer dhe mikro-ndërmarrjet." Në: Pop, D. (ed.) Modelet e reja të migrimit të punës në Evropën Qendrore dhe Lindore. Cluj Napoca: Qendra e Politikave Publike, fq.94-110;*
- *Kilic, T., Carletto, C., Davis, B. & Zezza, A. (2009). Investimi në vendlindje: Migracioni i kthimit dhe pronësia e biznesit në Shqipëri. Ekonomia e Tranzicionit, 17 (3), 587-623;*
- *Kilic, T., Carletto, G., Davis, B. and Zezza, A. (2007) Investimi në vendlindje: Migrimi i Kthimit dhe Pronësia e Biznesit në Shqipëri. Uashington: Dokumenti i Punës së Kërkimit të Politikave të Bankës Botërore, 4366;*
- *OECD. (2017). Kapitalizimi i migracionit të kthimit duke e bërë atë më tërheqës dhe të qëndrueshëm", në Ndërlidhjet ndërmjet Politikave Publike, Migrimit dhe Zhvillimit, OECD Publishing, Paris. DOI: <https://doi.org/10.1787/9789264265615-12-en>*
- *Cerase, F. P. (1974,) Pritshmëritë dhe realiteti: një rast studimor i migrimit të kthimit nga Shtetet e Bashkuara në Italinë Jugore. Rishikimi i Migracionit Ndërkombëtar 8 (2): 245–62;*
- *Dumon, W. (1986). "Problemet me të cilat përballen migrantët dhe anëtarët e familjeve të tyre, veçanërisht migrantët e gjeneratës së dytë, në kthimin dhe riintegrimin në vendet e tyre të origjinës." Migrimi Ndërkombëtar 24: 113–28;*
- *Cassarino, J. P. (2008). Kushtet e migrantëve të kthyer. Revista Ndërkombëtare për Shoqëritë Multikulturore, 10(2), 95–105;*

- Kerpaci, K. dhe Kuka, M. (2019). Identiteti në rrëfimet e migrantëve shqiptar të kthyer nga Greqia. *Revista e Kërkimeve Arsimore dhe Sociale*, 2 (6);
- Observatori dhe UNICEF. (2016). *Migrantët Shqiptar të Kthyer: Një Vështrim i Përqendruar te Fëmijët të Menaxhimit të të Dhënave*. Observatori/UNICEF: Tiranë;
- Rrjeti i Kombeve të Bashkuara për Migracionin. (2020). *Raport i Rishikimit të Statusit të Zbatimit të GCM në Shqipëri gjatë periudhës 2019-2020*; Marrë nga: [https://migrationnetwork.un.org/sites/default/files/docs/1-final\\_-\\_consolidatedreport\\_gcm\\_vr\\_albania\\_27\\_tetor\\_2020.pdf](https://migrationnetwork.un.org/sites/default/files/docs/1-final_-_consolidatedreport_gcm_vr_albania_27_tetor_2020.pdf)
- Mähönen, T. A., & Jasinskaja-Lahti, I. (2012). Pritshmëritë dhe përvojat e akulturimit si parashikues të mirëqenies psikologjike të migrantëve etnikë. *Revista e Psikologjisë Ndërkulturore*, 44 (5), 786–806; <https://doi.org/10.1177/0022022112466699>.
- Cena, E., & Heim, D. (2021). Një udhëtim për në vendlindje mbushur me keqardhje: migrimi i kthimit shqiptar në vazhden e krizës financiare globale të 2008. *Revista e Migracionit Ndërkombëtar dhe Integritit*, (20210623). <https://doi.org/10.1007/s12134-021-00853-x>
- Xhaho, A., Çaro, E., & Bailey, A. (2021). Fuqizim apo barrë e dyfishtë? Puna, familja dhe agjencia midis grave migrante shqiptare në Greqi. *Gjinia, Vendi dhe Kultura*, 28(10), 1431–1451. <https://doi.org/10.1080/0966369X.2020.1817872>



## SHTOJCA 1.

### Pyetje:

#### Pyetje e përgjithshme:

Më tregoni historinë tuaj të jetës?

#### Përvoja në vendin pritës:

Më tregoni për përvojën tuaj të punës ?

#### Kthimi në Shqipëri:

1. Më tregoni për vendimin tuaj për t'u kthyer në Shqipëri? Çfarë ju bëri të riktheheshit?
2. Ke ardhur me familjen apo vetëm?
3. Kush vendosi të kthehej në Shqipëri? A ishin dakord familjarët tuaj? A e mbështetën planin tuaj për t'u rikthyer në Shqipëri?
4. Keni pasur ndonjë plan orientimi përpara se të ktheheshit? Cilat ishin idetë/planet fillestare?
5. A keni marrë ndonjë ndihmë nga sportelet e migracionit apo programe/ institucione të tjera riintegrimi në nivel vendor?
6. Nëse po, më tregoni çfarë lloj ndihme ju kanë ofruar? Riintegrim në tregun e punës, ndihmë socio-kulturore, juridike? A ishte e dobishme?

#### RRJETI SOCIAL:

7. A keni pasur ndonjë anëtar të familjes ose nga rrjeti i miqve që ju kanë mbështetur? Çfarë bënë ata?
8. A keni mbajtur lidhje më herët me familjarët, miqtë? Si i mbanit këto lidhje?
9. A ju kanë shërbyer disi?
10. A e vizitonit shpesh Shqipërinë?

#### *Çfarë lloj problemesh keni hasur kur u kthyet në Shqipëri?*

#### Riintegrimi në tregun e punës:

1. Keni pasur ndonjë plan se ku do të preferonit të punonit në Shqipëri, në cilin sektor ekonomik?
2. Keni pasur ndonjë plan investimi?
3. Nëse po, më tregoni më shumë për planin tuaj konkret dhe si rezultoi kjo iniciativë? Cilat ishin sfidat kryesore me të cilat u përballët dhe si i keni zgjidhur problemet?
4. Kush e mbështeti planin tuaj të investimit? Çfarë lloj mbështetjeje tjetër do të kishit preferuar nga institucionet shtetërore/rrjeti familjar?
5. A keni pasur mundësi për të vënë në

zbatim ekspertizën tuaj të punës ose përvojën e veçantë që keni marrë në Greqi në punën tuaj aktuale?

6. Nëse nuk keni pasur ndonjë plan investimi, ku punoni? Jeni të kënaqur me punën që bëni?
7. Keni pasur mundësi të veni në zbatim ekspertizën tuaj të punës apo përvojën e veçantë që keni fituar në Greqi?
8. A është e vështirë të menaxhosh ekuilibrin midis punës dhe jetës personale këtu në Shqipëri?
9. Si ndryshon mjedisi/klima e punës nga ajo në vendin e destinacionit?
10. A mendoni se mjedisi i punës është mbështetës/mundësues?
11. A ka ndonjë ndryshim në kulturën etike të punës? Si ndryshon nga vendi jashtë?

### **Riintegrimi psiko-social:**

1. Si ishte rikthimi në Shqipëri pas x vitesh? Çfarë ka ndryshuar deri tani në aspektin social-kulturor?
2. Jeni të kënaqur me ndryshimet e reja? Ishte e vështirë për ty të mësoheshe me mjedisin e ri?
3. Jeni larguar nga Shqipëria në x. Që atëherë, shumë gjëra kanë ndryshuar. Si i përjetuat këto?  
ndryshime? Ishte stresues? Si e keni menaxhuar këtë situatë?
4. Po rrjeti juaj social këtu? A ishte e mundur të lidheni me miqtë tuaj të vjetër? Keni hasur vështirësi për të bërë miq të rinj? A shihni ndonjë ndryshim midis miqësisë ?

Po arsimi, mbrojtja sociale dhe strehimi? Keni pasur ndonjë ndihmë?

### **Shpërthimi i covid-19**

1. Si ka ndikuar situata e Covid-19 në vendimet/mënyrën tuaj të jetesës? Si mundët të përshtateni me këtë situatë të re?
2. A i përmbushi Shqipëria pritshmëritë tuaja (përsa i përket riintegrimit dhe perspektivës së jetës)?

### **Planet**

Cilat janë planet tuaja? Keni ndonjë plan për emigrim? Nëse po, cilat janë motivet pas këtij plani?